# Jetëshkrim



| | |
|---|---|
| **Informacion Personal** | |
| Emri / Mbiemri | **Denion Meidani** |
| Adresa | Rruga Dritan Hoxha, Tiranë, Shqipëri |
| Telefoni | +355 4 224 3918 |
| E-mail | denion.meidani@dogana.gov.al |
| Shtetësia | SHQIPTAR |

## Eksperiencat e punësimit

| | |
|---|---|
| Data | Qershor 2022 – aktualisht |
| Roli i pozicioni i punës | Drejtor i Pergjithshëm i Qendres së Koordinimit kundër Ekstremizmit të Dhunshëm / Koordinator Kombëtar |
| Aktivitetet kryesore dhe përgjegjësitë | Përgjegjës për të koordinuar programet që lidhen me de-redakalizimin, veçanërisht CVE, PVE, Paralajmërimi i Hershëm dhe Sistemi I Reagimit të Hershëm, dhe riintegrimi dhe mbrojtja e klasave të prekura të individëve si dhe fuqizimin e aktorëve të linjës së parë dhe ndërhyrjet që lidhen me mbështetjen dhe zbatimin e programit. |
| Emri i punëdhënësit | **Qendra e Koordinimit kundër Ekstremizmit të Dhunshëm** |
| Data | Janar 2021 – Qershor 2022 |
| Roli ose pozicioni i punës | Zv. Drejtor i Përgjithshëm në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, Departamenti Analizave dhe Aposteriorit |
| Aktivitet kryesore dhe përgjegjësitë | Siguron adminsitrimin e efektshëm, si dhe drejton, bashkërendon punën e mbikëqyr veprimtarinë e kryer nga departamenti që mbulon. Menaxhon të gjitha procedurat doganore që lidhen me regjimet doganore dhe mallrat e akcizës, operacionet e privilegjuara, përditësimin e Nomeklaturës së Kombinuar të mallrave, zbatimin e rregullores së origjinës, etj. Menaxhon me eficensë veprimtarinë e drejtorive nën varësi, nxjerr akte nënligjore të nivelit të tretë që mbulojnë fushat specifike të departamentit sipas propozimeve të strukturave direkte, në përputhje me kompetencat. |
| Emri i punëdhënësit | **Drejtoria e Përgjithshme e Doganave** |
| Data | Tetor 2020 – Dhjetor 2021 |
| Roli ose pozicioni i punës | Konsulent |
| Aktivitet kryesore dhe përgjegjësitë | Pergatit strategjinë rajonale të zhvillimit të markës dhe përshtatjen e kësaj strategjie me kushtet dhe kontekstin lokal. Ofron zgjidhje kreative për problematika dhe dilema të ndryshme dhe reagon me proaktivitet në situata eksplicite. Ofron këshilla dhe ekspertizë për kompaninë për t'i ndihmuiar ata të përmirësojnë perfromancën e tyre të biznesit për sa i përket operacioneve, përfitimit, menaxhimit, strukturës dhe strategjisë. Puna shtrihet në një sërë fushash, duke përfshirë menaxhimin, strategjinë, IT, financat, marketingun, burimet njerëzore dhe menaxhimin e zinxhirit të furnizimit. |
| Emri i punëdhënësit | **Renault Kosovo** |
| Data | Prill 2018 – Tetor 2020 |
| Roli ose pozicioni i punës | Drejtor i Monitorimit, Kontrollit dhe Inspektimit |
| Aktivitet kryesore dhe përgjegjësitë | Objekti i veprimtarisë së Drejtorisë së Monitorimeve, Kontrollit dhe Inspektimeve është kryerja e detyrave që lidhen me zbatimin e detyrimeve dhe ushtrimine kompetencave ligjore të AKEP-it për monitorimin e spektrit të frekuencave, zbatueshmërinë e standardeve dhe cilësisë të rrjeteve dhe ofrimit të shërbimeve publike të komunikimeve elektronike, si dhe inspektimin e veprimtarisë së sipërmarrësve të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike publike dhe të shërbimit postar ose çdo personi tjetër fizik apo juridik që zhvillon veprimtari në fushën e komunikimeve elektronike dhe atë të shërbimit postar. |
| Emri i punëdhënësit | **Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare** |
| **Data** | Qershor 2017 – Dhjetor 2017 |
| Roli ose pozicioni i punës | Drejtor i Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Sistemin e Burgjeve |

| | |
|---|---|
| Aktivitetet kryesore dhe përgjegjësitë | Parandalon, zbulon, dokumenton dhe heton paraprakisht veprimtaritë kriminale, të kryera nga punonjës të Policisë së Burgjeve, nga struktura të tjera të sistemit të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe për çështje që lidhen me sigurinë në burgje. Drejton, mbikqyr ligjshmërinë dhe siguron ushtrimin normal të veprimtarisë së SHKBB-së për të siguruar zbatimin e ligjit në veprimtarinë informative dhe gjurmuese. Bashkëpunon, shkëmben informacione e ndërton plane të përbashkëta veprimtarie me Shërbimin Informativ të Shtetit, me Shërbimin e Kontrollit të Brendshëm në Ministrinë e Rendit Publik, me Policinë e Shtetit, si dhe me shërbime e struktura të tjera operative gjurmuese. |
| Emri i punëdhënsit | **Ministria e Drejtësisë** |
| | |
| Data | Gusht 2015 – Qershor 2017 |
| Roli ose pozicioni i punës | Startup Strategist & Konsulent Marketingu |
| Aktivitetet kryesore dhe përgjegjësitë | Asiston në zhvillimin, komunikimin, ekzekutimin dhe mirëmbajtjen e iniciativave strategjike. Harton politikat dhe strategjitë e marketingut të shoqërisë. Zhvillon buxhetet e marketingut në përputhje me politikat dhe strategjitë e marketingut të shoqërisë. Drejton dhe mbikëqyr funksionet e marketingut të shoqërisë për të identifikuar dhe zhvilluar përdorues të rinj për produktet dhe shërbimet e ofruara nga shoqëria. Harton ofertat e produkteve dhe shërbimeve që duhet të ofrojë shoqëria në treg. Paraqet propozimet përkatëse pranë Drejtorit të Përgjithshëm ose Këshillit Ekzekutiv të shoqërisë. Mbikëqyr, planifikon dhe zhvillon materialet e marketingut dhe të komunikimit të shoqërisë. Udhëheq marketingun e produkteve ose shërbimeve të reja të hedhura në treg nga shoqëria. Administron dhe zhvillon marrëdhëniet me publikun të shoqërisë dhe mbikëqyr përgatitjen, prodhimin dhe shpërndarjen e materialeve të shitjeve, ekspozimeve dhe programeve të promocionit etj. |
| Emri i punëdhënsit | **KFC ALBANIA** |
| | |
| Data | Mars 2015 – Mars 2017 |
| Roli ose pozicioni i punës | Konsulent Marketingu dhe Komunikimi |
| Aktivitetet kryesore dhe përgjegjësitë | Bazuar në strategjinë afatmesme të kompanisë dhe planin e saj të biznesit, harton Planin e Përgjithshëm të Marketingut dhe propozon buxhetin e marketingut bazuar në këtë plan. Pas aprovimit ndjek nga afër zbatimin e Planit te Marketingut. Është përgjegjës per PR e kompanisë, për imazhin dhe paraqitjen e saj në media, në Ëeb dhe në Rrjet. Është përgjegjës për hartimin e strategjisë së fushatave të marketingut (të brendshme dhe të jashtme) për të siguruar efiçencen maksimale të tyre përsa i përket brandit, penetrimit të mesazhit dhe diferencimin nga konkurrentet. |
| Emri i punëdhënsit | **Punto Pay dhe Pay & Go** |
| | |
| Data | Shkurt 2014 – Prill 2017 |
| Roli ose pozicioni i punës | Menaxher Projekti |
| Aktivitetet kryesore dhe përgjegjësitë | Planifikon, ekzekuton dhe finalizon zbatimin e projekteve sipas afateve kohore dhe brenda buxhetit të projektit. Siguron dhe interpreton informacionin teknik dhe financiar në kompani dhe jashtë saj në funksion të realizimit të projektit. Detajon dhe kthen në plan pune objektivat e projektit dhe mbikëqyr zbatimin, respektimin e buxhetit dhe të cilësisë nga fillimi deri në përfundimin e projektit. Zbaton strategjine dhe vlerëson për të reduktuar kostot. Përfaqëson kompaninë me palë të treta për temat e lidhura me projektin dhe mbikëqyr, siguron, raporton dhe mban përgjegjesi edhe për përformancën e ekipit/stafit të projektit. Raporton përpara investitorit dhe CEO të kompanisë në mënyrë periodike në varësi të kërkesave të projektit. Zhvillon fushata prokurimi periodike sipas nevojave për produkte të kompanisë dhe të projektit si dhe fushata periodike kontrolli të kushteve të tregut – cilësi dhe çmim të materialeve që po meren sipas kontratave ekzistuse |
| Emri i punëdhënsit | **Building Construction SHPK** |
| | |
| Data | Janar 2014 – Prill 2017 |
| Roli ose pozicioni i punës | Menaxher Projekti |
| Aktivitetet kryesore dhe përgjegjësitë | Bashkërendon marrëdhëniet dhe komunikimin me autoritetet vendore për projekte të ndryshme, për lejet, liçensat dhe aplikimet e nevojshme gjatë fazave të zhvillimit të projektit. Kujdeset për ruajtjen e marrëdhënies dhe koordinimin me konsulentë të jashtëm të projektit. Përgjegjës për bashkërendimin me studiot projektuese gjatë gjithë marrëdhënies me to për finalizimin e detyrave dhe harmonizimin e reflektimin e ndryshimeve. Kryen analiza, identifikon problematika, rekomandon shërbime, asiston në implementimin e projektit duke ofruar suport analitik, praktik dhe ndjekje në terren. Vlerëson riskun i cili përfshin krahasimin e riskur të vlerësuar me kritere të vendosura nga kompania, të tilla si: kosto, kërkesa ligjore, faktorë të ambjentit dhe vlerësimi i mënyrës së mëparshme të manaxhimit të riskut nga kompania. Përpilon në bashkëpunim me Departamentin e Financës buxhetin e projektit, nevojës për financim/investim dhe nivelin e shpenzimeve të pritshme. Kujdeset për matjen dhe raportin e kthimit financiar si dhe përfitimeve të tjera jo financiare. Pjesëmarrës në ndërtimin e planeve strategjike afatgjata dhe implementimin e planeve strategjike operacionale. |
| Emri i punëdhënsit | **Energy Development Group** |
| | |
| Data | Tetor 2015 – Qershor 2016 |
| Roli ose pozicioni i punës | Pronar & Menaxher i Përgjithshëm |

| | |
|---|---|
| Aktivitetet kryesore dhe përgjegjësitë | Mbikëqyr funksionet operacionale të përditshme të lokalit. Është përgjegjës për punësimin dhe supervisimin e stafit si dhe të të ftuarve në lokal. Vendos kanalet e reklamimit – print, TV, radio, etj. si dhe krijon dhe mirëmban një buxhet për marketingun e kompanisë. Mbikëqyr negociatat me të ftuarit dhe përpilon kontratat përkatëse. Përgjegjësi të tjera përfshijne: trajnim dhe supervizim personeli, porosi inventari, dhe sigurimi i standarteve ligjore dhe higjenike. |
| Emri i punëdhënsit | **Angazhim ne aktivitet privat** |
| Data | Shtator 2013 – Janar 2014 |
| Roli ose pozicioni i punës | Drejtor i Antikontrabandes dhe Rikuperimit të Borxhit |
| Aktivitetet kryesore dhe përgjegjësitë | Drejtori i Antikontrabandes është personi përgjegjës për drejtimin e kësaj force në parandalimin e çdo lloj forme aktiviteti kontrabandimi e trafikimi të jashtëligjshëm në territorin doganor. Funksionet kryesore te saj janë përpunimi i strategjive dhe i planit antikontrabande, kryerja e kontrolleve fizike dhe dokumentare ne baze te te dhënave te analizimit te riskut, ne çdo vend brenda territorit doganor te Republikës se Shqipërisë, duke shqyrtuar mallrat, personat dhe mjetet e transportit, për te zbuluar dhe frenuar kontrabandën brenda territorit doganor shqiptar dhe nga territori i vendeve te tjera. Nëpërmjet kontrolleve identifikon dhe jep te dhëna për veprimtarinë ose personal e dyshimte dhe për data base-in e te dhënave. Gjithashtu, kjo drejtori ndihmon ne hetimin e shkeljeve doganore. Raporton tek Zv. Drejtori i Përgjithshëm i Doganave dhe ka nën varësi një sërë specialistësh dhe operatorësh. |
| Emri i punëdhënsit | **Drejtoria e Përgjithshme e Doganave** |
| Data | Maj 2013 – Shkurt 2014 |
| Roli ose pozicioni i punës | Drejtor i Përgjithshëm/Administrator |
| Aktivitetet kryesore dhe përgjegjësitë | Menaxhon objektivat afatmesme dhe afatgjata të kompanisë. Supervizon stafin, delegon detyrat, krijon objektiva afatgjata lidhur me shitjet dhe buxhetimin. Është përgjegjës për rritjen e përfitueshmërisë së kompanisë si dhe për penetrimin në një segment të gjerë të tregut të medias. Takohet rregullisht me anëtarë të Bordit Drejtues për të planifikuar startegjinë dhe rritjen e kompanisë. |
| Emri i punëdhënsit | **OK! Magazine & Antenna Albania** |
| Data | Dhjetor 2011 – Shtator 2013 |
| Roli ose pozicioni i punës | Drejtor i Shërbimit të Kontrollit të Brenshdshem në Sistemin e Burgjeve |
| Aktivitetet kryesore dhe përgjegjësitë | Parandalon, zbulon, dokumenton dhe heton paraprakisht veprimtaritë kriminale, të kryera nga punonjës të Policisë së Burgjeve, nga struktura të tjera të sistemit të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe për çështje që lidhen me sigurinë në burgje. Drejton, mbikqyr ligjshmërinë dhe siguron ushtrimin normal të veprimtarisë së SHKBB-së për të siguruar zbatimin e ligjit në veprimtarinë informative dhe gjurmuese. Bashkëpunon, shkëmben informacione e ndërton plane të përbashkëta veprimtarie me Shërbimin Informativ të Shtetit, me Shërbimin e Kontrollit të Brendshëm në Ministrinë e Rendit Publik, me Policinë e Shtetit, si dhe me shërbime e struktura të tjera operative gjurmuese. |
| Emri i punëdhënsit | **Ministria e Drejtësisë** |
| Data | Qershor 2010 – May 2011 |
| Roli ose pozicioni i punës | Zv. Drejtor i Përgjithshëm Ekonomik |
| Aktivitetet kryesore dhe përgjegjësitë | Planifikon, organizon, koordinon dhe kontrollon aktivitetin ekonomik të kompanisë duke siguruar përputhshmërinë me politikat, procedurat, dhe legjislacionin përkatës. Gjithashtu monitoron, planifikon, koordinon dhe udhëheq projekte të brendshme dhe të jashtme në sinkron me objektivat e parashikuara nga kompania si dhe drejton, negocion dhe auditon programet dhe procedurat e furnizimit me shumicë. |
| Emri i punëdhënsit | **KESH SH.A.** |
| Data | Prill 2010 – Qershor 2011 |
| Roli ose pozicioni i punës | Drejtor i Përgjithshëm për Politikat Ekonomike dhe Zhvillimit |
| Aktivitetet kryesore dhe përgjegjësitë | Bashkëpunon ngushtë me Ministrin e Ekonomisë dhe përfaqësues të tjerë të lartë shtetëror për të planifikuar dhe promovuar politikat e tregut dhe zhvillimin ekonomik të Shqipërisë. Ofron asistencë individëve, sipërmarrësve privat, si dhe institucioneve të shtetit për të zhvilluar biznesin e tyre dhe situatën ekonomike në vend dhe rajon. Planifikon dhe koordninon projekte zhvillimi në vend dhe rajon. Raporton tek Ministri i Ekonomisë. |
| Emri i punëdhënsit | **Ministria e Ekonomisë, Tregëtisë dhe Energjisë** |
| Data | Prill 2008 – Shtator 2009 |
| Roli ose pozicioni i punës | Chief Strategy Officer |
| Aktivitetet kryesore dhe përgjegjësitë | Asiston në zhvillimin, komunikimin dhe zhvillimin e strategjisë afatmesme dhe afatgjatë të kompanisë. Përpilon plane dhe objektiva strategjike që kanë për qëllim rritjen e performancës financiare të kompanisë si dhe kapjen e një segmenti të gjërë të tregut. Është përgjegjës për të siguaruar që veprimet dhe procedurat e kompanise nuk bien ndesh me legjislacionin vendas dhe ndërkombëtare. |
| Emri i punëdhënsit | **StarSat Albania** |

| | |
|---|---|
| Data | Prill 2005 – Janar 2008 |
| Roli ose pozicioni i punës | Këshilltar i Prokurorit të Përgjithshëm |
| Aktivitetet kryesore dhe përgjegjësitë | Këshillon prokurorin e përgjithshëm për çështje të rëndësisë së lartë. Bashkëpunon ngushtë me keshilltarët e përfaqësues të tjerë në qeveri si dhe agjenci ligjzbatuese për një koordinim efektiv. Përfaqëson dhe shoqëron Prokurorin e Përgjithshëm në aktivitete, takime e konferenca ndërkombëtare dhe mban kontakte e marrdhënie në funksion të detyrave të lëna nga Prokurori Përgjithshëm. Drejton njësinë e Projekteve ne Prokurorië e Përgjithshme. Për ushtrimin e detyrave të përcaktuara nga ligji për prokurorinë ose nevojat që burojnë nga ligje të veçanta, përpilon urdhëra dhe udhëzime të ndryshme për t'u miratuar nga Prokurori i Përgjithshëm si dhe ndjek zbatueshmërinë e tyre. |
| Emri i punëdhënsit | **Prokuroria e Përgjithshme** |
| Data | Prill 2004 – Shkurt 2005 |
| Roli ose pozicioni i punës | Këshilltar i Drejtorit të Përgjithshëm |
| Aktivitetet kryesore dhe përgjegjësitë | Bashkëpunon ngushtë me drejtorin e përgjithshëm në çështje të cilat kërkojnë profesionalizëm të posaçëm dhe kanë një rëndësi specifike. Asiston në mbarevajtjen e planit strategjik të kompanisë dhe ofron këshillim që i sjell kompanisë siguri, përfitueshmëri, dhe efikasitet. Ndjek në vecanti departamentin e Marketingut dhe të Shitjeve. |
| Emri i punëdhënsit | **Sigma Vienna Insurance Group** |
| Data | Korrik 2002 – Gusht 2004 |
| Roli ose pozicioni i punës | Këshilltar i Ministrit të Punëve të Jashtme |
| Aktivitetet kryesore dhe përgjegjësitë | Promovon aktivitetin dhe reformat e ndërmarra nga Ministria e Punëve të Jashtme. Krijon produkte analitike si raporte këshillimi, memo, vlerësime të ndryshme. Përfaqëson Shqiperinë në forume dhe mbledhje ndërkombëtare dhe përgatit fjalime dhe prezantime për aktivitete të ndryshme si dhe formulon udhëzime e akte nënligjore për miratim. |
| Emri i punëdhënësit | **Ministria e Punëve të Jashtme** |

## Arsimi

| | |
|---|---|
| Data | Mars 2013 |
| Titulli i kualifikimit të arritur | Master i Shkencave |
| Temat kryesore / aftësitë e mbuluara nga edukimi / trajnimi | Administrim Biznes |
| Emri dhe lloji i subjektit që ofroi edukimin ose trajnimin | Bocconi University, Milano, Itali |
| Data | Qershor 2002 |
| Titulli i kualifikimit të arritur | Master Profesional |
| Temat kryesore / aftësitë e mbuluara nga edukimi / trajnimi | Diplomaci (Tema: International Economy) |
| Emri dhe lloji i subjektit që ofroi edukimin ose trajnimin | University of Malta, MEDAC, Msida, Malta |
| Data | May 2001 |
| Titulli i kualifikimit të arritur | Master i Shkencave |
| Temat kryesore / aftësitë e mbuluara nga edukimi / trajnimi | Shkenca Kompjuterike<br>Qeverisje dhe Marrëdhenie Ndërkombëtare |
| Emri dhe lloji i subjektit që ofroi edukimin ose trajnimin | Clark University, Worcester, MA, USA |
| Data | Qershor 1997 |

| | |
|---|---|
| Titulli i kualifikimit të arritur | Kolegji Privat 'Mehmet Akif', Diplomë Shkollë e Mesme |
| **Gjuhët** | Gjuha nënës: **SHQIP**<br>**Gjuhë të tjera:** Anglisht – C2; Italisht – C1; Turqisht – B2 |